



*VENDIM*

*Nr. 113, Datë 08.07.2016*

**MBI  
MIRATIMIN E RREGULLORES PËR NDRYSHIMIN E FURNIZUESIT  
TË ENERGJISE ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 88 pika 2 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe nenit 25 të Rregullores se Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr. 96, datë 17.06.2016, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 08.07.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorive teknike të ERE, në lidhje me miratimin e “Rregullores për ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike”

**Konstatoi se:**

- ERE është organi kompetent për hartimin dhe miratimin e kësaj rregulloreje.
- Njihësimi i praktikës së rregullave për ndryshimin e furnizuesit në sektorin e energjisë elektrike, krijon lehtësira për të gjithë operatorët e tregut.
- Rregullorja e ndryshimit të furnizuesit përcakton kushtet, të drejtat dhe detyrimet e furnizuesve dhe klienteve të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE :

**Vendosi:**

1. Miratimin e Rregullores për ndryshimin e furnizuesit të energjisë elektrike.  
(bashkëlidhur këtij vendimi)

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë të interesuarit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**  
**Petrit AHMETI**